

KOMPONENTI NR.6

TITULLI: “Njohja dhe vleresimi i treguesve të pjellorisë dhe degradimit të tokave bujqesore në zonën fushore bregdetare, për një planifikim dhe administrim racional të tyre”, në komunën Fier Shegan të rrethit të Lushnjës.

Rekomandime

Nisur nga konkluzionet e dalura nga ky studim do të rekomandohet masat e cituara më poshtë:

- Rreth 15.8 % e tokave të kësaj zone që rezultojnë të renda nga perberje fizike, të cilat paraqesin vështirësi për punimin dhe kullimin e ujrave gjatë sezonit të rreshjeve kërkojnë trajtim të veçantë për ujitjen dhe punimin e tyre;
- Meqenëse reaksioni i tokës (pH) në këto zone luhet në vlerat nga 7.5 – 8.4, përdorimi i plehrave që kanë tendencë të acidifikueshëm do të ndikonte negativisht në uljen e kësaj treguesi në tokë, drejt neutralitetit;
- Meqenëse rreth 31.6 % të këtyre tokave janë të varfëra në humus, me të duhet punuar kryesisht në drejtim të ruajtjes së nivelit aktual, por njëkohësisht dhe pasurimit të tyre me lëndë organike. Kjo do të realizohet nëpërmjet plehrimit organik ose mbjelljes së kulturave shumë vjeçare që lënë mbetje të konsiderueshme të lëndës organike në tokë. Përdorimi i plehrut organik, plehrimit të gjelbër, kashtës së grurit dhe mbjellja e kulturave që sigurojnë sasi të bollshme të lëndës organike, do të krijojnë një ekuilibër të aktivitetit mikrobik në tokë, garantim të një bilanci pozitiv të humusit, mobilizim të fosforit, potasit dhe azotit dhe për pasojë do të kemi rritje të pjellorisë aktuale të tokës. Sugjerojmë që të përdoren edhe dy vjet norma të larta të plehrave organike që shkojnë nga 30 – 50 kg/dy.
- Meqenëse këto toka kanë shkallë relativisht të ulët mineralizimi të lëndës organike, është e nevojshme që të bëhet aktivizimi i saj nëpërmjet përdorimit të plehrave kimike dhe kryesisht atyre fosfatike;
- Realizimi i prodhimeve të larta në kulturat bujqesore në këto zone, ku rreth gjysmën e tokave kanë përmbajtje të ulët të azotit, kërkon kompensim të kësaj elementi nëpërmjet përdorimit të plehrave azotik në nivele relativisht të larta. Gjithashtu, përdorimi i plehrave azotike që ndikojnë në acidifikimin e tokës do të ndikonte negativisht në zhvillimin normal të bimëve;
- Meqenëse më shumë se 80 % e këtyre tokave kanë nivel të ulët të fosforit, ato kanë nevojë për doza të larta dhe të konsiderueshme plehrash fosfatike, ndërsa përdorimi i plehrave potasike do të jetë i kufizuar;
- Parcelat që kanë vlera të raportit Ca/Mg rreth 1-1.5, duhet të monitorohen në vazhdimësi për përmbajtjen e Mg, për të parë nëse këto raporte janë të rastit, apo përbejnë një fenomen që tenton të çojë drejt çfaqjes së shenjave të kripezimit magnezial të këtyre tokave.

- Per te arritur rendimente te larta ne kulturat bujqesore qe tradicionalisht mbillen ne kete zone, sugjerojme qe plehrat te perdoren sipas normave te pasqyruara ne tabelat e dhena ne raport, ne pjesen qe trajton teknologjite e plehrimit te kulturave bujqesore;
- Do te sugjeronim qe nga ana e komunes te behet kerkesa prane qarkut te Fierit, nga i cili varet administratvisht, per miratimin e studimit te siperfaqes se tokave qe nuk jane trajtuar per vlersimin e pjellorise potenciale (bonitetit);
- Nga vleresimi i frekuencen se tipeve te ndryshme te perdorimit te tokes ne periudhen 1991 – 2008, ka rezultuar se ne pergjithesi nuk ka patur ndryshime te medha ne perdorimin e tokes, ndersa ne nje pjese te saj kemi konvertim nga; bujqesore ne zone urbane, nga livadhe ne urbane, ullishte ne pyje, peme frutore ne pyje, livadhe ne vreshta, vreshta ne livadhe dhe peme futore ne livadhe. Ndryshimet e nivelit te ulet ne perdorimin e tokes jane shume te pakta si, modifikimi ne Bujqesore, qe do te thote se kemi ndryshime nga peme frutore ne ullishte ose anasjelltas. Megjithese siperfaqet te cilat u jane nenshtuar ndryshimeve nuk jane te medha nga ana e komunes duhet te ndiqet me seriozitet perdorimi i tokes, duke e lidhur ate me tipin dhe pershtatshmerine e tokes. Eshte e nevojshme qe ne rastet e perdorimeve te papershtatshme si ne rastin e konvertimeve nga bujqesore ne jo bujqesore te vihen barriera per ta frenuar keto zhvillime negative. Ndersa ne rastet e perdorimeve te pershtatshme te tokes te mundesohen subvencione (kjo eshte ne perputhje me disa nisma te ndermarra nga Ministria, si rastet e subvencioneve ne vreshta apo ullishte).
- Gerryeshmeria e tokes ne kete zone eshte ne kufinjte nga 5.5 ton/ha/vit deri 7 ton/ha/vit. Faktoret tokesor dhe klimatik jane elementet baze te rrezikut potencial te erozionit te tokes, ndersa *rreziku aktual* i erozionit eshte i ndikuar nga mbulesa bimore. Per kete qellim koeficienti i mbuleses bimore duhet te jete jo me pak se 1.5;
- Aplikimi i formave te sistemimit siperfaqesore duhet te sigurojne rritjen e koeficientit te pershkueshmerise se tokes, dhe ruajtjen e vlerave te hidromodulit te kullimit te percaktuar ne projekt;
- Per te parandaluar dhe minimizuar gerryerjen e tokes, perparesi ne sistemin e punimit te tokes per zonen kodrinore duhet te kete punimi ne nje krah, ndersa ne pergjithesi perparesi duhet te kene punimet konservative(ruajtes) dhe ato minimale ne kalim dhe thellesi;
- Aplikimi i metodologjise CORINE e percaktuar nga FAO, i aplikuar ne kete zone konsiderohet i efektshem ne percaktimin e rrezikut potencial dhe aktual te tokes dhe mund te gjej zbatim edhe ne vleresimin e ketij rreziku ne te gjithe zonen fushore te vendit tone;
- Ne lidhje me regjimin uJOR te kesaj zone mendojme qe; financimi i projekteve te zbatimit per kullimin te behet me nje vlere prej 5 milion leke, qe do te garantoj evitimin e përmbytjeve dhe do te rrise punen e gjalle, qe do te materializohet edhe me rezultatet e prodhimit ne kete zone;
- Financimi i projektit te zbatimit per ujitjen prej 3.72 milion leke eshte domosdoshmeri per rritjen e rentabilitetit te kulturave bujqesore te kesaj zone;

- Mendojme qe rehabilitimi i stacioneve te pompimit nuk eshte me efektivitet per shkak te kostos se larte qe ka. Njekohesisht, shpenzime ka edhe mirembajtja e tyre, por eshte e vetmja mundesi per ujitjen e tokave bujqesore te fshatit Kosove e Vogel, qe shtrihet ne zonen kodrinore. Mendimi yne eshte qe ketyre tokave ti jepet perparesi zhvillimit te pentarise.

KOORDINATORI

Prof. As. Dr. Skender BELALLA